

VENDIM
Nr.197, datë 10.4.2004

PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE
JOPUBLIKE “UFO DENTAL”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1, 12 e 13 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare jopublike “Ufo Dental”, sipas kërkesave të përcaktuara në vendimin nr.156, datë 22.3.2001 të Këshillit të Ministrave “Për shkollat e larta jopublike në Republikën e Shqipërisë”.

2. Shkolla e lartë jopublike “Ufo Dental”, të jetë e nivelit universitar, me degën e vetme stomatologji.

3. Kjo shkollë ta zhvillojë veprimtarinë në mjediset e veta, me adresë: Rruga “Kajo Karafili”, nr.22, Tiranë.

4 . Kohëzgjatja e kursit të studimit të jetë 4 vjet.

5. Titulli i diplomës, që jepet në përfundim të studimeve të plota universitare, është “Mjek stomatolog i përgjithshëm”.

6. Ngarkohet Ministri i Arsimit dhe i Shkencës për kryerjen e procesit të vlerësimit dhe të akreditimit të njohjes së kursit të studimit dhe për zbatimin e ligjshmërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano